

# AKT - THEMELIMI

I

## SHOQERISE TREGETARE “ LADI - TOURS AL” SH.P.K.

Ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “ Per shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Biznesit”, dhe te ligjeve te tjera qe lidhen me veprimtarine tregtare ne Republiken e Shqiperise , sot me date 27.03.2021 me vullnetin e tij te lire shtetasi **Arjan TAFANI**, atesia Shaqir i dtl. 15/08/1976 lindur ne Belsh e banues ne Gradishte, Belsh, Bashkia Belsh, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. 031231624 dhe numer personal H60815016G , vendos per krijimin dhe themelimin e shoqerise tregtare “ **LADI - TOURS AL**”sh.p.k , si vijon :

### NENI 1

#### THEMELIMI DHE EMERTIMI I SHOQERISE

Ortaku themelues Arjan Tafani themelon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar e te emertuar “ **LADI-TOURS AL**” sh.p.k .

Shoqeria, e formuar me iniciativen e ortakut themelues, konsiderohet e themeluar ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkangjitur ketij akti.

Shoqeria i nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen jashte territorit te Republikes se Shqiperise do t’i nenshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete qendren dega. Deget e shoqerise do te ushtrojne veprimtarine ne emer dhe per llogari te kesaj shoqerie dhe brenda kopetencave qe do tu jene dhene me aktet e krijimit apo me akte te tjera te vecanta.

### NENI 2

#### E DREJTA

Shoqeria “ **LADI-TOURS AL**” sh.p.k. eshte person juridik i se drejtes shqiptare e themeluar me vendim te ortakeve themelues qe ushtron veprimtarine e saj tregtare ne perputhje dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne fuqi si ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite tregtare” dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” .

### NENI 3

#### FORMA JURIDIKE DHE PERGJEGJESIA

Shoqeria eshte Person Juridik Privat Shqiptar.

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontribudit te themelueseve te saj ne kapitalin themeltar.

Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj per detyrimet e saj ndaj te treteve.

Ajo nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve ne vecanti, po per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

**NENI 4**  
**SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria e ka seline e saj ne Gradishte, Belsh me adrese ne : Rruga Elbasan –Belsh, Dumreja 00980029, Ndertesa Nr.88, Hyrja 1.

Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

**NENI 5**  
**KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar me perjashtim te rastit kur ortaket me Vendim te Asamblese se Ortave ose Ortaku i Vetem vendosin nje prishje te parakohshme te saj ose vendosin per shkurtrim apo dhe shtytje te metejshme, etj.

**NENI 6**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**Objekti i veprimtarise se saj do te jete :**

- Transport nderkombetar udhetaresh me autobuz ne linje turistike
- Agjenci turistike

**NENI 7**  
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga “ortaku i vetem“ i shoqerise Arjan Tafani dhe perbehet nga 1 (nje) pjese/kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (njqindmije) lekë, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) .

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Te gjithë kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht.

Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

**NENI 8**  
**SHTIMI OSE PAKESIMI I KAIPTALIT**

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.



## **NENI 9 TRANSFERIMI I KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaket mund t'u shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi t'ua kene ofruar per blerje ortakeve brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te treteve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakeve te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

## **NENI 10 SHPERNDARJA E FITIMIT**

Ortaket-Ortaku vetem financojne, perfitojne rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltar.  
Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem, shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete.

## **NENI 11 VULA E SHOQERISE**

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "**LADI-TOURS AL**" sh.p.k , **Albania**.

## **NENI 12 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve-Ortaku i Vetem- organi me i larte vendim-marres.
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

## **NENI 13 ADMINISTRATORI**

Administrator i shoqerise "**LADI-TOURS AL**" sh.p.k. eshte **Arjan TAFANI** .  
Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca ne drejtimin e saj .

## **NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori ushtron kompetenca ne emer te Shoqerise.

1. Administratori disponon pasuri te shoqerise ne favor te realizimit te te ardhurave per Shoqerine.
2. Administratori i shoqerise ka kompetencat per drejtimin e shoqerise me qellim qe shoqeria te realizoje Objektin e saj.



3. Administratori nuk ka ato kompetenca qe statuti dhe ligji ua njeh shprehimisht Asamblese se Ortakeve-Ortakut te vetem. Administratori perfaqeson Shoqerine ne marredhenie me te tretet si dhe perpara Organeve Administrative dhe Gjyqesore.
4. Administratori ka Kompetence te miratoje Llogarite Vjetore dhe paraqitjen e tyre nese eshte rasti per miratim perfundimtar nga Asambleja e Ortakeve.
5. Redaktimin e rregulloreve te brendshme te shoqerise.
6. Krijimin e strukturave te reja brenda shoqerise apo c'do Organi tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te Shoqerise.
7. Perzgjedhjen e ekspertit kontabel dhe te komisionit te likuidimit.
8. Organizimi i mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve-Ortakut te vetem mund te behet edhe nga administratori.
9. Leshon certifikata e aftesi sipas nenit 77 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008.
10. Administratori nese do te tejkaloje percaktimet e Statutit dhe ligjit angazhon pergjegjesine e tij penale per shperdorim detyre.

#### **NENI 15** **BAZA LIGJORE PER NDRYSHIMET**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, administratoret, kapitalin, seline, ortaket, objektin e veprimtarise, etj, sipas vendimit qe do te merret nga Mbledhja e Ortakeve dhe sipas kerkesave te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite Tregetare" duke depozituar vendimin prane rregjistrimit tregetar te Qendres Kombetare te Rregjistrimit.

#### **NENI 16** **LOGARITE**

Shoqeria do te realizoje transaksionet e saj financiare nepermjet llogarive rrjedhese qe do te hape ne bankat shqiptare dhe te huaja. Per kapitakin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive dhe shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin financiar ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale.

#### **NENI 17** **BILANCI**

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqerise ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor. Viti ushtrimor do te perkoje me vitin kalendarik.

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjitha veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjitha legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci financiar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratori brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem,shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete,si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshme.



**NENI 18  
PERFAQSIMI**

E drejta per te perfaqsuar shoqerine para cdo organi shteteror, privat, bankar , gjyqsor , etj ushtrohet nga Administratori i Shoqerise ose nga nje person tjetër i autorizuar me prokure nga Administratori.

**NENI 19  
ZBATIMI I LIGJIT**

Persa nuk eshte shprehur ne kete Akt Themelimi dhe Statut, vlejne dispozitat e Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregetare" ; Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" dhe ligjeve te tjera qe lidhen me veprimtarine tregetare ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 20  
VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT**

Shoqeria konsiderohet e riorganizuar dhe krijuar ne perputhje me nenet e ketij Akti – Themelimi e te Statutit bashkelidhur Aktit.

**NENI 21  
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Mosmarreveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortakët e shoqerise me mirekuptim nese jane me shume se nje ortak, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

**NENI 22**

Ky akt perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

**ORTAKU THEMELUES  
I SHOQERISE „LADI-TOURS AL” SHPK.**

**Arjan TAFANI**

AR JAN TAFANI

